



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

PRILL 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



↙ Aksioni Pastrimi Kombëtar, në prag të sezonit turistik veror!

Një mobilizim i gjerë i udhëhequr nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mbrojtjes, bashkitë, organizatat mjedisore dhe qindra vullnetarë. Ky aksion synon të rrisë ndërgjegjësimin për përkujdesjen ndaj mjedisit, jo vetëm në bregdet, por në çdo aspekt të jetës sonë.



↘ Çelet projekti "Vjosa e Gjelbër"

Ministri Jaupaj dhe Ministri Federal gjerman për Mjedisin, Carsten Schneider, lançuan projektin "Green Vjosa", një hap i rëndësishëm për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj pasurie unike natyrore. Gjatë vizitës në Parkun Kombëtar të Lumit Vjosa, u theksua rëndësia e tij si lumi i fundit i egër në Evropë dhe një simbol i biodiversitetit dhe së ardhmes së gjelbër.



↙ Ministri Sofjan Jaupaj pret në vizitë zyrtare Ministren Fitore Pacolli

Mirëpritëm në Tiranë Ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës, Fitore Pacolli, me të cilën nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit për Lumin Drin, një hap i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në mbrojtje të këtij sistemi ujor të rëndësishëm në rajon.



↘ Elbasan - Konferenca "Zbatimi i Kontratës Klimatike të Qytetit"

Elbasani është një nga 112 qytetet evropiane të përzgjedhura në kuadër të Misionit të Qyteteve dhe një nga vetëm 3 qytetet e Ballkanit Perëndimor me këtë status. Konfirmohet angazhimi dhe rrugëtimi i Elbasanit drejt neutralitetit klimatik, duke synuar të shërbejë si model inovacioni dhe transformimi për qytetet e tjera deri në vitin 2050.

➤ Samiti i Diasporës – Mjedisi dhe Integrimi Evropian

Në Samitin e Katërt të Diasporës i kushtuam një hapësirë mjedisit, biodiversitetit dhe natyrës, për të ndarë punën që po bëhet dhe për të përfituar nga ekspertiza e diasporës. Ky kapitull i ri ndërton një partneritet të qëndrueshëm për zhvillim, investime të gjelbra dhe inovacion.



➤ Nis programi "EU for Forests"

Ky program përbën një hap konkret drejt mbrojtjes dhe rigjallërimit të pyjeve tona në partneritet me Bashkimin Evropian, UNDP dhe AICS, bashkëpunëtorë të çmuar me të cilët po ndërtojmë një sektor pyjor më të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet europiane, duke vijuar paralelisht reformat për përafrimin e kuadrit ligjor me acquis të BE.

➤ Në Ditën e Tokës, nisëm fushatën kombëtare "Mburo natyrën, sa je në kohë"

Nga shkolla 9-vjeçare "Musine Kokalari" në Tiranë, së bashku me Ministren e Arsimit Mirela Kumbaro Furxhi dhe Ambasadorin e Delegacionit Evropian në Shqipëri Silvio Gonzato, ndamë me të rinjtë mesazhin për t'u bërë ambasadorë të natyrës përmes veprimeve tona të vogla të përditshme, duke u kujdesur për mjedisin dhe për mënyrën si ndikojmë tek njëri-tjetri.



➤ Investimi i ri i TITAN për uljen e ndotjes së ajrit.

Kur vizioni i qeverisë bashkohet me inovacionin e sektorit privat dhe mbështetjen e Komisionit Evropian, projektet kthehen në motor transformimi për industrinë shqiptare. Titan Albania është një shembull konkret i këtij evolucioni drejt standardeve europiane, me më shumë konkurrueshmëri, qëndrueshmëri dhe orientim nga e ardhmja.

↙ Miratohet VKM për Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve.

Programi 2026-2030 synon forcimin e kuadrit rregullator, nxitjen e konsumit të qëndrueshëm dhe reduktimin e mbetjeve në sektorë kryesorë. Zbatimi i tij, në bashkëpunim me institucionet, biznesin dhe qytetarët, do të sjellë më pak ndotje dhe një sistem më të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA



Firmoset Marrëveshja e Bashkëpunimit me ELSA Albania ↘

Ministri Jaupaj ndau me studentët dhe të rinjtë profesionistë një moment bashkëpunimi mes Ministrisë së Mjedisit dhe ELSA Albania, i formalizuar përmes Memorandumit të Mirëkuptimit. Ky hap vendos në qendër të rinjtë dhe rolin e tyre në procesin e integritit evropian.

↙ Ministri Jaupaj merr pjesë në takimin e dytë të Komitetit Drejtues për Ekonominë Qarkulluese dhe Menaxhimin Rajonal të Mbetjeve

Me reformën në sektorin e mbetjeve kemi kaluar nga depozitimi drejt riciklimit, rikuperimit dhe ekonomisë qarkulluese. Projektet në Vlorë Jug-Gjirokastrë dhe Kukës, me investime në landfille sanitare, stacione transferimi dhe rehabilitim të venddepozitimeve, dëshmojnë këtë angazhim në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.



↘ Është publikuar për konsultim projektligji për krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Si një ndërmarrje me kapital 100% shtetëror, ajo do të marrë përgjegjësinë për administrimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurisë pyjore. Ky hap shënon kalimin nga një sistem i fragmentuar drejt një modeli të organizuar dhe profesional, në përputhje me standardet evropiane.



↘ Mirëpritëm në Tiranë MedProgramme

Me përfaqësues nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe partnerë ndërkombëtarë u zhvillua një platformë e përbashkët dialogu për çështjet mjedisore në Mesdhe. Ky angazhim mbështet rrugëtimin drejt BE-së dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke kaluar nga qasje të fragmentuara në zgjidhje afatgjata, pasi mjedisi nuk njeh kufij.



Mbledhja e përbashkët e Komisioneve Parlamentare në Sarandë ↙

Ministria e Mjedisit, në mbledhjen e përbashkët të komisioneve parlamentare, theksoi se përmes mbështetjes financiare për bashkitë, zgjerimit të shërbimit të pastrimit dhe modernizimit të flotës, synon një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, veçanërisht në zonat turistike me fluks të lartë.

↘ Vizitë studimore e stafit të Ministrisë së Mjedisit për Kuadrin Kombëtar të Shërbimeve Klimatike

Një delegacion i kryesuar nga Ministria e Mjedisit, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera, ndodhet në Zvicër dhe Belgjikë për avancimin e Kuadrit Kombëtar për Shërbimet Klimatike (#NFCS). Përmes takimeve me partnerë ndërkombëtarë, po njihen modele të suksesshme dhe po synohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe integrimi i tyre në politikat

